



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 639/2 Prot.

Tiranë, më 17 / 05 / 2018

**V E N D I M**

**Nr. 123 , Datë 17 / 05 / 2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 59, datë 10.05.2018, të paraqitur nga A.C kundër Degës Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Familja e A.C në Dhjetor të vitit 2007 ka lidhur kontratë me Degën Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave për marrjen e një banese me kredi. Deri në vitin 2014, shlyerja e pagesave nga ana e saj nuk ka qenë e rregullt për arsye se kishte vështirësi ekonomike. Me vendim gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është vendosur prishja e kontratës së A.C me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë dhe kalimi i urdhërit të ekzekutimit për zbatim pranë Zyrës Përmbarimore Korçë. Pas negociatave dhe ndërhyrjeve të kryera nga përfaqësues të shoqërisë civile në ndihmë të komunitetit egjiptian, është pezulluar urdhri i ekzekutimit dhe është nënshkruar një marrëveshje e re ndërmjet familjes së A.C dhe Drejtorisë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave. Familja e A.C përbëhet nga tri fëmijë dhe bashkëshorti i papunë, dhe njëri nga fëmijët është me aftësi të kufizuara. Në vitin 2015 ka kërkuar nga Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Korçë që të përfitonte zbritje në vlerën e kredisë në masën 10% pasi kishte një fëmijë me aftësi të kufizuara por ka marrë përgjigje se nuk e përfiton për arsye se nuk ka një kontratë të vlefshme me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë.

Nga verifikimet e kryera rezulton se ankesa e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga ana e A.C ka të njëjtin objekt dhe shkak me ankesën nr. 123, datë 15.09.2017 të bërë nga bashkëshorti i saj. Në Vendimin nr. 27, datë 19.01.2018, Komisioneri në mes të tjerash është shprehur se: “- Nga analizimi në tërësi i fakteve dhe provave të administruara përgjatë procesit të hetimit administrativ, rezulton se lidhur me pretendimin e A.C për diskriminim për shkak të “racës”, nga ana e Bashkisë Korçë, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak se i përket komunitetit egjiptian. Ankuesi nuk ka zbatuar dispozitat përkatëse, ligjore dhe nuk ka depozituar minimalisht një kërkesë me shkrim për përfitim granti të menjëherëshëm pranë Bashkisë Korçë. - Lidhur me pretendimin e A.C për diskriminim për shkak të racës, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, Komisioneri vë në dukje se pavarësisht faktit se

*Aktmarrëveshja nr. 263, datë 04.11.2014, e lidhur ndërmjet ankuesit dhe EKB Korçë është konstatuar nga organi epror i këtij institucioni, si një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, të tilla Aktmarrëveshje janë lidhur edhe me dy familje te tjera që nuk i përkasin komunitetit egjiptian. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se trajtimi i padrejtë dhe disfavorizues i EKB Korçë, ndaj A.C nuk lidhet me përkatësinë e tij në komunitetin egjiptian”.*

Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin Nr. 27, datë 19.01.2018, në të cilët në është vendosur: “1- Konstatimi i mosdiskriminimit, për shkak të racës (egjiptiane) të A.C, nga ana e Bashkisë Korçë, dhe 2- Konstatimi i mosdiskriminimit, për shkak të racës (egjiptiane) të A.C, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë”.

Në këtë kontekst, rezulton se e njëjta çështje është shqyrtuar njëherë, janë kryer të gjitha procedurat hetimore dhe ka rezultuar se nuk ka patur trajtim të padrejtë dhe disfavorizues të familjes A.C, për shkak të racës nga ana e Drejtorisë Rajonale Korçë të Entit Kombëtar të Banesave.

Pas analizimit të ankesës nr. 59, datë 10.05.2018, të A.C, u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa nuk i plotëson kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Së pari**, në nenin 33, pika 4, gërma c), të këtij ligji parashikohet:

*“4. Ankesa nuk pranohet nëse:*

*a).....*

*b).....*

*c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;*

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në neni 1, 3, 7/1, nenet 20, 21/1, neni 32/1/a) dhe nenin 33, pika 4, gërma c), të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së A.C, pasi për të njëjtën çështje është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**